



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER SOKOL SH. MALAJ  
ADRESA NR.2, LUIGJ GURAKUQI  
TEL: 684055554

# VËRTETIM NËNSHKRIMI NË AKTE TË NDRYSHME OSE NË DEKLARATA PERSONALE

Nr. repertori: 996

Tirane më 17/05/2022

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



V2022050710058115582



## Akti i Themelimit

I

### SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "ITsysCOM" Shpk

---

## **AKT THEMELIMI**

Në bazë të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe ligjit nr. 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", sot, më 17.05.2022, ortakët themelues:

- **Z.DAN CHRISTIAN BOGOS**, lindur ne DEVA me 20.06.1979 , me pasaporte nr. CF1M2VGG3, madhor dhe me zoteri te plote per te vepruar.

me vullnetin e tij te lire e te plote, te shprehur nepermjet ketij akti themelimi, vendosi per krijimin e Shoqerise "ITsysCOM" sh.p.k me kushtet e meposhtme :

### **Neni 1**

#### **Forma, selia e shoqerise**

Shoqeria "ITsysCOM" Sh.p.k , themelohet si Shoqeri Tregtare me pergjegjesi te kufizuar, bazuar ne ligjin nr. **9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"**. Ajo eshte Person Juridik Privat Shqiptar.

Selia e saj ndodhet ne Qytetin e Tiranë me adrese, Rr"Kavajës" Qendra Gurten shpk (Godina Volkswagen), Zyra 306,.

Ne varesi te aktivitetit tregetar shoqeria mund te hape dege apo filiale te saj ne qytete te ndryshme te Shqiperise ose jashte vendit, sipas legjislacionit te vendit perkates.

Ndryshimi i selise se shoqerise do te behet ne formen e kerkuar nga ligji.

### **Neni 2**

#### **Pergjegjesia e ortakeve**

Veprimtaria e Shoqerise bazohet ne normat e ketij Akti Themelimi, Statutit te Shoqerise, si dhe Legjislacionit Shqiptar ne fuqi.

Themeluesit e saj mbajne pergjegjesi vetem per detyrimet qe krijon Shoqeria dhe brenda vleres se kapitalit themeltar.

Shoqeria nuk pergjigjet per detyrimet qe mund te kene ortakët themelues para krijimit te saj, para futjes ne shoqeri apo per shkak te veprimtarive te tjera.

### **Neni 3**

#### **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte i perbere nga kontributi i ortakut themelues ne vleren 1000 (njemije) leke.

Kapitali themeltar i shoqërisë "ITsysCOM" shpk në momentin e themelimit të shoqërisë është fiksuar në shumën 1000 (njemije)lekë dhe do të depozitohet në llogarinë e shoqërisë pranë një banke shqiptare.

Kapitali është i përbërë nga 1 kuote me një vlerë prej 1000 lekë secila.

Kontributet e ortakëve në kapitalin themeltar të shoqërisë janë si më poshtë:

Z.DAN CHRISTIAN BOGOS, zotëron 100% të kapitalit themeltar ose 1 kuote.

Vleresimi kapitalit themeltar eshte bere nga Ortaket Themelues me rastin e miratimit te ketij Akti Themelimi dhe eshte nenshkruar prej tij.

Zmadhimi i kapitalit te shoqerise do te behet ne formen e parashikuar nga ligji.

Shoqeria ka te drejte te transferoje kapitalin e saj.

#### **Neni 4 Derdhja e kapitalit**

Mbas rregjistrimit te Shoqerise kjo shume do te kaloje ne llogarine e kesaj Shoqerie qe do te celet prane njeres prej Bankave ne Tirane.

Shoqeria rezervon te drejten e terheqjes se kredive prej bankave qe zhvillojne aktivitetin tregtar ne Shqiperi, sipas kritereve te percaktuara prej tyre.

#### **Neni 5 Objekti i Veprimtarise te shoqerise.**

Shoqeria, ne perputhje me legjislacionin shqiptar, do te kete si objekt te veprimtarise se saj :

- Zhvillim, administrim, implementim dhe shitje të programeve kompjuterike.
- Konsulencë në Industrinë e Teknologjisë së Informacionit.

Shoqëria mund të ndërmarrë të gjitha transaksionet e biznesit, industriale dhe financiare të cilat i konsideron të nevojshme dhe të dobishme për arritjen e objektit të shoqërisë brenda dhe duke respektuar kufijtë ligjorë në fuqi.

Shoqëria, për arritjen e objektit të aktivitetit tregtar, mund të marrë me qira ose të menaxhojë shoqëri apo degë të shoqërive, të japë ose të marrë përfaqesi si agjenci, për të komisionuar në mënyrë direkte ato ose indirekte, për të fituar interesa ose pjesëmarrje në shoqëri të tjera që kanë objekte të ngjashme, të lidhura ose të ngjashme me objektin e aktivitetit tregtar të vet, të transaksionojë kredi ose/dhe hipoteka, të blejë apo shesë pasuri të patundshme, makineri dhe pajisje, si dhe çdo gjë tjetër të nevojshme për menaxhimin e aktivitetit.

Shoqëria mund të organizojnë panairë për ekspozimin e produkteve shqiptare ose produkteve dhe shërbimeve të shoqërive të huaja, duke u kujdesur për reklamimin dhe mirëmbajtjen e ekzkluzivitetit të tregut në territorin shqiptar, në bashkëpunim me këto shoqëri.

Shoqeria brenda hapesirave te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi, do te kryeje çdo operacion tregtar dhe financiar qe lidhet drejtperdrejt ose terthorazi me objektin e veprimtarise se saj. Kjo perfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive te reja, krijimin e siper marrjeve te reja dhe pjese marrjen ne siper marrje te tjera, si brenda dhe jashte vendit, pa cenuar objektin e shoqerise.

#### **Neni 6 Afati i shoqerise**

Shoqeria do te funksionojë me nje afat kohor te pacaktuar.  
Afati i fillimit te veprimtarise fillon mbas regjistrimit te Shoqerise ne Regjistrin Tregtar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.  
Ajo mund te pushoje aktivitetin e saj ne cdo kohe kur jane rastet e parashikuara ne ligj ose me vendim te Asamblese se Ortakeve, duke u zbatuar procedurat e caktuara me ligj.

#### **Neni 7 Ortaket**

Ortaket Themelues mund te vendosin per pranimin ne shoqeri te personave te tjere me cilesine e Ortakeve, pasi te jene kryer procedurat e nevojshme te parashikuara nga ligji.

#### **Neni 8 Heqja dore nga shoqeria**

Ortaket Themelues si dhe ortaket e tjere ne te ardhmen mund te heqin dore nga Shoqeria por gjithnje per shkaqe te perligjura.  
Heqja dore, nuk e shkarkon Ortakun nga detyrimet e Shoqerise deri ne momentin e heqjes dore. Ne rast vdekje te Ortakut detyrimet u kalojne trashegimtareve ligjore sipas aktit te trashegimnise se leshuar nga organi kompetent.

#### **Neni 9**

Investimet dhe veprimtaria e Shoqerise gezojne mbrojtjen e shtetit Shqiptar, i cili krijon te njejtat kushte si per subjektet shqiptare ashtu edhe ato te huaja.

#### **Neni 10 Fitimi i shoqerise**

Fitimi i realizuar kalon ne pronesi te Ortakeve Themelues ose te Ortakeve te tjere (nese ka), ne perputhje me pjese marrjen e Ortakeve ne kapitalin themeltar.  
Fitimi eshte lirisht i transferueshem brenda edhe jashte shtetit shqiptar.

#### **Neni 11 Detyrat e orkave themelues**

Ortaket themelues kane sidomos keto detyrime:  
-Te regjistrojne Shoqerine ne Regjistrin Tregtar dhe te marrin lejen e ushtrimit te aktivitetit te veprimtarise se tyre.

- IPERIS  
KALAU
- Te derdhe kapitalin e nevojshem per fillimin e aktivitetit te Shoqerise.
  - Te siguroje mjediset e nevojshme per fillimin e aktivitetit, makinerite, pajisjet e nevojshme.
  - Te siguroje mundesite e specializimit te fuqise punetore dhe specialisteve per zhvillimin e aktivitetit te Shoqerise.
  - Te siguroje objektet dhe makinerite e Shoqerise nga çdo lloj demtimi.
  - Te menaxhoje prodhimin e ta reklamojne ate nepermjet mjeteve te ndryshme te informacionit.

## **Neni 12**

### **Organet e shoqerise**

Organet drejtuese te Shoqerise jane:

- Asambleja e Ortakeve
- Administratori.
- Ekspertet Kontabel (kur te jete nevoja).

**Administratori i shoqerise eshte caktuar per nje periudhe 3 (tre) vjeçare, Z. ORSID HOXHAIJ.**

Menyra e veprimtarise se tyre eshte percaktuar ne Statutin e Shoqerise.

## **Neni 13**

### **Aktiviteti i shoqerise**

Per kryerjen e aktivitetit te saj, shoqeria mund te punesoje specialiste apo punetore vendas apo te huaj sipas rregullave perkatese. Marredheniet e punesimit do te rregullohen me anen e kontrates dhe brenda legjislacionit shqiptar.

Shoqeria mund te hyje ne marredhenie kontraktuale me subjekte te tjera brenda apo jashte vendit, duke u rregulluar keto marredhenie ne bazen e kontrates.

## **Neni 14**

### **Sekreti i shoqerise**

Ortaket detyrohen te ruajne sekretin e themelimit dhe te veprimtarise se Shoqerise.

Te punesuarit dhe te ngarkuarit me drejtimin e Shoqerise mbajne pergjegjesi dhe detyrohen te zhdemtojne Shoqerine per demet qe i jane shkaktuar per faj te tyre gjate ushtrimit te veprimtarise.

## **Neni 15**

Ortaket mund te vendosin me vullnetin e tyre, per pjesmarrjen ne Shoqeri te tjera dhe te krijojne cdo lloj aktiviteti tjeter privat.

## **Neni 16**

### **Zgjidhja e mosmarreshjeve**

Mosmarrveshjet lidhur me themelimin dhe zhvillimin e veprimtarise se Shoqerise zgjidhen nga vete Ortaket me mirekuptim dhe kompromis dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga gjykata

kompetente. Po keshtu, mosmarveshjet midis te treteve dhe shoqerise si dhe midis shoqerise dhe personave te punesuar ne te, ne rast se nuk zgjidhen ne rrugen e mirekuptimit do te zgjidhen nga gjykata kompetente.

Gjykata kompetente per zgjidhjen e mosmarveshjeve eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

#### **Neni 17**

Problemet e pa trajtuara ne Aktin e Themelimit apo te trajtuara shkurt do te zgjidhen gjithmone sipas kerkesave te ligjit baze "Per shoqerite tregtare".

Akti i Themelimit pasi u lexua nga Ortaku Themelues, u nenshkrua prej tij pa verejtje para Noteres te vendit te themelimit te Shoqerise.

**Ortaku themelues**

**Z.DAN CHRISTIAN BOGOS**

DAN CHRISTIAN BOGOS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË  
NOTER SOKOL SH. MALAJ



V2022050710058115582

DATE 17/05/2022  
NR REP 996

**VËRTETIM NËNSHKRIMI**

Sot, më datë 17 Maj 2022 (dy mije e njëzet e dy), ditën e martë, para meje Noter SOKOL SH. MALAJ, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën TIRANE, NR.2, LUIGJ GURAKUQI, u paraqit personalisht:

**DEKLARUES:**

**Z.DAN CHRISTIAN BOGOS**, lindur ne DEVA me 20.06.1979 , me pasaporte nr. CF1M2VGG3, madhor dhe me zoteri te plote per te vepruar i cili deklaroi se nuk kupton gjuhën shqipe dhe asistohet në gjuhën angleze nga përkthyesja e tij e besuar **Znj FIONA MIHALI** e bija e Theodor dhe Violeta lindur në Tiranë më 01.07.1984 banuese në Tiranë Rr.”Mihal Duri”, Pall 58, Shk 1, Ap 1, e paisur me Kartën e Identitetit #032824095# me Nr personal #I45701069B#, madhore me zotësi të plotë për të vepruar.

Deklaruesi i mësipërm, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqit dhe nënshkroi përpara meje Noterit, dokumentin bashkëlidhur, Akt-Themelimi dhe Statutin e shoqërisë “ITsysCOM” shpk.

Unë Noteri, pasi verifikova identitetin e personit të sipërcituar, nëpërmjet mjetit të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma “ë”, si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018“Për Noterinë”, dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tij.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTER**

**SOKOL SH. MALAJ**



**NOTER. SOKOL SH. MALAJ**  
RR“LUIGJ GURAKUQI” P 2 TIRANË, ALBANIA  
Tel: +355 4 222 98 32 / Cel: +355 68 40 5555 4  
e-mail: kolimalaj@hotmail.de